



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.367/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Burim Ademi kryesues, Zyhdi Haziri dhe Ferki Xhaferi, anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjor Edona Grajçevci, duke vendosur përkitazi me ankesën subjektivit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidates Jeta Statovci subjektivit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor - posterët në rrugë publike, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 12.02.2021, mori këtë:

## V E N D I M

**I. PRANOHET** e bazuar ankesa A.nr.367/2021 e datës 11.02.2021 e ushtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër kandidates Jeta Statovci subjektivit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për subjektet politike - vendosja e posterëve për fushatën zgjedhore mbi rrugë publike, në shtyllën elektrike në Komunën Prishtinë, i shqiptohet gjobë në lartësi prej 1,200.00 (njëmijë e dyqind) euro.

**II. DETYROHET** Subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -I-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e marrjes së këtij vendimi, nën kërcënim e shqiptimit të dënimit shtesë.

## A r s y e t i m

Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë A.nr.367/2021 me datë 11.02.2021, me të cilën pretendon se në rrugën publike përkatësisht në shtyllën elektrike, në Ulpianë, Prishtinë, kanë hasur në poster të kandidates për deputete të subjektivit politik LVV. Me këtë rast nga ana e këtij subjekti është bërë shkelja e nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur disa fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Parashtruesi i përgjigjes në ankesë thekson se më datë 11.02.2021, kemi pranuar ankesën e parashtruesit e Partisë Demokratike të Kosovës, përmes panelit PZAP-së me shkresën e bashkëlidhur me nr 365/2 lidhur me kërkesën për përgjigje dhe urdhër për të ndërmarr masat përimituese për ankesën Anr345. Në ankesë parashtruesi pretendon se “kandidatja nga radhët e LVV, Jeta Statovci në kundërshtim me nenin 33 pika b te LZP-së, lidhur me nenin 4 pika b të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2013. Ka vendosur postier në shtyllën elektrike në Ulpianë, Prishtinë”.

Nga leximi dhe shqyrtimi i Ankesës konsiderojmë se Ankesa është e pasafatshme sepse parashtruesi nuk ka cekur ditën kur i ka pa dy posterët në Ulpianë. Pra kjo ankesë është e pasafatshme dhe nuk i ka plotësuar kriteret e parapara me nenin 5, par.5, pika 5 te Rregullës

02/2015 te PZAP-së. Kjo për faktin se ata dy postiera janë vendosur nga kandidatja për deputete e LVV-së Jeta Statovci para katër ditësh, po dhe atë ditë pasi që jemi njoftuar me këtë veprim aktivistet e LVV-së kanë hequr ato postierë nga shtyllat elektrike.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e bazuar**

Nga shkresat e lëndës vërtetohet se Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, ka parashtruar ankesë A.nr.367/2021 me datë 11.02.2021, me të cilën pretendon se në rrugën publike përkatësisht në shtyllën elektrike, në Ulpianë, Prishtinë, kanë hasur në poster të kandidatës për deputete të subjektit politik LVV. Pas pranimit të ankesës në PZAP, e njëjta i është dërguar subjektit politik LVV për përgjigje në ankesë.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave, e posaçërisht nga fotot e ofruara si provë nga parashtruesi i ankesës, të cilat gjenden në shkresat e lëndës, në mënyrë të padyshimtë, ka konstatuar se materialet zgjedhore - posterit i kandidatës për deputete nga subjektit politik LVV, është vendosur në hapësirat publike-rrugë, përkatësisht shtyll elektrike, veprim ky që është në kundërshtim me nenin 33 pika b) e LZP-së, e cila përcakton *“Vendosja e njoftimeve, pllakateve dhe postereve, ose përndryshe, vendosja e emrave të tyre ose e sloganeve në lidhje me fushatën zgjedhore brenda ose jashtë ndërtesave publike ose godinave, në apo mbi rrugë publike, në shenjat publike të trafikut, brenda ose jashtë hapësirave ose ndërtesave të zëna ose, ndryshe, që shfrytëzohen nga organizatat ndërkombëtare, ose brenda ose në hapësirat private pa lejen e pronarëve ose shfrytëzuesve”*.

Paneli lidhur me pretendimin e faktit se ankesa është e pasafatshme, rezulton se ankesa është paraqitur me date 11.02.2021, në PZAP që e bënë ankesën të paraqitur brenda afatit, pasi që kjo konsiderohet shkelje nga momenti kur parashtruesi i ankesës ka vërejtur posterët e tillë në vendin publik.

Ndërsa fakti se foto janë vendosur në shtylla publike ato si të tilla përbëjnë hapësira publike që janë të ndaluara për tu vendosur materialet gjate fushatës zgjedhore.

Paneli, vendimin e tij e ka mbështet në dëshmi të qarta dhe bindëse siç përcaktohet me nenin 117 par. 3 të LZP-së, prandaj pretendimet në përgjigje në ankesë nuk u cilësuan me ndikim në meritat e lëndës.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalët, shkallën dhe peshën e shkeljes, pjesëmarrjen e subjekti politik në zgjedhjet e mëparshme që konsiston në faktin së subjekti politik LVV, ka qenë e njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës, shkeljet e rregullave dhe Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje dhe në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë që do të thotë se i njëjti është i njoftuar me Rregullat zgjedhore si dhe shumën e fondeve që ka marrë subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve lidhur me fushatën zgjedhore. Paneli po ashtu me rastin e përcaktimit për lartësinë e gjobës

ka marrë parasysh edhe përgjigjen në ankesë të subjektit politik LVV, ku me dy fotografi të printuar dëshmohet se posterët janë larguar dhe kjo vlerësohet ndërmarrje e masave përmirësuese, e cila pastaj ka pasur ndikim në uljen e lartësisë së gjobës kur janë vlerësuar të gjitha rrethanat për lartësinë e tille.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), në kuadër të pretendimeve të theksuara në përgjigje në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin jo relevante dhe pa ndikim për një vendimarrje ndryshe nga ajo që është vendos.

Nëse subjekti të cilit i është shqiptuar dënimi nuk e paguan të njëjtin brenda afatit të përcaktuar në dispozitiv të tij, atëherë në pajtim me nenin 120.2 të LZP-së, subjektit do ti shqiptohet dënim shtesë. Ky paralajmërim për dënim shtesë është përcaktuar me nenin 120.2 të LZP, i cili përcakton: “ 120.2 Dështimi për të paguar dënimin apo për t’ju bindur një urdhërese të PZAP-it brenda periudhës kohore të saktësuar në vendimin e PZAP-it, është një shkelje tjetër e këtij ligji që mund të sanksionohet me dënim shtesë nga PZAP-i. ”, ashtu siç është vendosur në pikën II të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**  
Anr. 367/2021 më datën 11.02.2021

**Kryesuesi i Panelit**

Burim Agami



**Këshilla Juridike:** Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa sipas nenit 118.1 të par. 4 të LZP-së,